

Rregullore e shtëpisë

për institucionet urbane të strehimit të përkohshëm për refugjatët dhe personat e pastrehë në Stadt Münster (qytetin Münster)

Në bazë të përcaktimeve të § 3 kryerreshti 4 të statutit të Stadt Münster për përdorimin e institucioneve urbane të strehimit të përkohshëm për refugjatët dhe personat e pastrehë, të datës 16.12.2016, lëshohet kjo Rregullore e shtëpisë me sa vijon në vazhdim:

§ 1 Të përgjithshmet

(1) Stadt Münster mirëmban institucione për strehim të përkohshëm të refugjatëve dhe personave të pastrehë. Për mbështetjen e saj, ajo ka porositur me detyrë bartës jopublik. Detajet janë të përcaktuara nëpërmes statutit për përdorimin e shtëpive të strehimit të përkohshëm urban për refugjatët dhe personat e pastrehë në Stadt Münster.

(2) Në institucionet urbane të strehimit të përkohshëm njerëzit jetojnë ngushtë me njëri-tjetrin së bashku. Kjo rregullore e shtëpisë ju informon Ju mbi detyrat e banoreve dhe banorëve si dhe të vizitoreve dhe të vizitorëve.

(3) Për një bashkëjetesë të mirë, përveç rregullave të rregullores së shtëpisë, gjithashtu thelbësore janë edhe pranimi i ndërsjellë, konsiderimi i ndërsjellë dhe gadishmëria për të ndihmuar të tjerët.

(4) Institucionet e strehimit të përkohshëm janë vende pa dhunë. Çdo lloj i dhunës fizike, verbale ose psikike, si dhe çdo formë tjetër e diskriminimit nuk do të tolerohen asesi.

§ 2 Personat e kontaktit - E drejta e shtëpisë

(1) Stadt Münster dhe bartësit jopublik i menaxhojnë institucionet urbane të strehimit të përkohshëm. Ata qëndrojnë në dispozicion për të gjitha pyetjet e hapura të cilat kanë të bëjnë me institucionet e strehimit të përkohshëm. Shërbimi social dhe shërbimi i shtëpisë siguron kujdesin dhe strehimin e duhur të banoreve dhe të banorëve.

(2) Punonjësit e ushtrojnë të drejtën e shtëpisë. Ata duhet të kontrollojnë rregullisht respektimin e Rregullores së shtëpisë. Urdhrat e tyre duhet të ndiqen.

§ 3 Marrëdhënia e përdorimit

(1) Marrëdhënia e përdorimit ju nënshtrohet të drejtës publike. Askush nuk gëzon një të drejtë ligjore, për t'u vendosur në një institucion të caktuar të strehimit të përkohshëm, në dhoma të caktuara ose në dhoma të një lloji dhe madhësie specifike.

(2) Në institucionet e strehimit të përkohshëm familjeve ose personave të vetëm të gjinisë së njëjtë, ju jipet në dispozicion hapsirë e duhur banimi. Personat e vetëm nuk kanë të drejtë për të ju u përcaktuar atyre një dhomë e vetme.

(3) Personat me të drejtë përdorimi, në çdo kohë për arsye objektive mund të caktohen për banim në institucione tjera të strehimit të përkohshëm. E drejta për të përdorur qendrën e strehimit mund të revokohet. Detaje të mëtejshme rregullohen nëpërmes statutit të Stadt Münster për përdorimin e institucioneve urbane të strehimit të përkohshëm për refugjatët dhe personat e pastrehë.

§ 4 E drejta e qasjes

Punonjësit zyrtar të Stadt Münster si dhe bashkëpunëtorët e bartësve jopublik mund të hyjnë në të gjitha dhomat, objektet dhe stabilimentet e qendrave:

- Ditëve të punës ndërmjet orës 7 dhe 18 pas njoftimit në kohë të duhur dhe nëse një e tillë kërkohet përshkak të arsyeve objektive (p.sh. riparime, kontrollit të gjendjes, lexime të aparateve matëse), nëse është e nevojshme edhe me zejtarët dhe zejtarët e duhur.
- në çdo kohë në rast rreziku të menjëhershëm.

§ 5 Ambientet

(1) Dhomat të cilat janë dhënë në dispozicion përdorimi, mund të përdoren vetëm nga personat e udhëzuar për banim në to dhe vetëm për nevoja banimi. Mbajtja e kafshëve është e ndaluar.

(2) Banoret dhe banorët janë të detyruar të trajtojnë me kujdes të duhur dhomat e caktuara atyre për banim dhe inventarin e ofruar në to. Asnjë mobilje ose pajisje elektrike nuk mund të hiqen nga dhomat apo dhomat e përdorimit të përbashkët ose të rindërtohen. Vendosja e mobiljeve ose pajisjeve elektrike private është parimisht e ndaluar. Për përjashtimet e mundshme vendosin udhëheqësia përkatëse e institucionit të vendosjes.

(3) Banoret dhe banorët nuk e kanë të lejuar të vendosin pjata satelitore në institucionet e strehimit të përkohshëm ose t'i vendosin të njëjtat në ndërtesë. Instalimi i linjeve telefonike, respektivisht porositja e vendosjes së të njëjtave, gjithashtu nuk është e lejueshme.

(4) Banoret dhe banorët nuk e kanë të lejuar të bëjnë asnjë lloj ndryshimesh në institucionet e strehimit të përkohshëm.

(5) Banoret dhe banorët duhet të sigurojnë një ngrohje dhe ajrosje të mjaftueshme të dhomave të dhëna atyre në dispozicion përdorimi në institucionet e strehimit të përkohshëm.

(6) Dhomat ekzistuese për përdorim të përbashkët, mund të përdoren edhe për projekte me bazë vullnetare në koordinim me Stadt Münster.

§ 6 Siguria

(1) Personat të cilët banojnë ose vizitojnë institucionet e strehimit të përkohshëm, për arsye të sigurisë duhet të mbajnë në çdo kohë me qasje të lirë me sa vijon:

- të gjitha dritaret dhe dyert, korridoret, shkallët e shtëpisë dhe arkadat,
- Rrugët e shpëtimit dhe të ikjes, rruget qasëse të Zjarrëfiksesve dhe hyrjet në ndërtesa, korridoret e bodrumit, dhomat e tharjes dhe dhomat e lavanderisë nuk mund të përdoren si mundësi vendosjeje- ose magazinim objektësh. Objektet e vendosura pa leje, do të largohen menjëher nga punonjëset ose punonjësit përgjegjës dhe atë pa ndonjë kërkesë të mëtejshme.

(2) Rregulloret e përgjithshme të mbrojtjes nga zjarri janë për tu respektuar. Flaka dhe zjarri i hapur nuk lejohen. Lëndët e zjarrit dhe ato me rrezik shpërrthimi nuk lejohet të magazinohen në institucionet e strehimit të përkohshëm. Aparatet e fikjes së zjarrit dhe sistemet e alarmit të zjarrit, është e lejueshme të përdoren vetëm në rast zjarri.

(3) Sëmundjet me obligim lajmrimi sipas dispozitave ligjore të §§ 6 dhe 34 të Ligjit mbi Mbrojtjen ndaj infeksioneve, janë për të ju lajmruar menjëherë shërbimit social ose atij shtëpiak, nga vetë personat e prekur nga sëmundja ose nga banoret dhe banorët e tjerë të cilët kanë njohuri për të tillat. Sëmundjet me obligim lajmrimi përfshijnë ndër të tjera këto sëmundje: kolera, difteria, hepatiti, infektimi me morra të kokës, fruthi, meningitii, shyta, kolla e mirë, murtaja, rubeola, tërbimi, tifoja ose tuberkulozi.

(4) Në institucionet e strehimit të përkohshëm ekziston një ndalim absolut i pirjes së duhanit. Ai person i cili pin duhan në një institucion strehimi, duhet të llogaritet me një gjobë.

§ 7 Rendi

(1) Banoret dhe banorët janë të detyruar të respektojnë lirin e shtëpisë dhe të marrin në konsideratë të duhur njëri-tjetrin. Zhurma shqetësuese duhet të shmanget në çdo kohë të ditës ose të natës. Pushimi i natës nga ora 22 deri në orën 7 duhet të respektohet.

(2) Personat e paautorizuar për banim mund të qëndrojnë në mjediset e institucioneve të strehimit të përkohshëm ose në zonat të cilat i takojnë atyre, vetëm nga ora 7 deri në orën 22.

(3) Ushtrimi i një veprimtarie tregtare ose të pavarur pune, të çfarëdo lloji, nuk lejohet as në mjediset e institucioneve të strehimit të përkohshëm e as në zonat të cilat i takojnë atyre.

(4) Makinat larëse (lavatriqet) dhe makinat e tharjes mund të përdoren vetëm nga ana e banoreve dhe banorëve të institucioneve të strehimit të përkohshëm për të pastruar rrobat e tyre. Duhet të ndiqen patjetër udhëzimet për përdorimin e pajisjeve. Kapacitetet e pajisjeve duhet të respektohen dhe shfrytëzohen në mënyrë të duhur.

(5) Uji mund të konsumohet vetëm për nevojat e duhura në amvisërin individuale dhe për pastrimin e institucioneve të strehimit të përkohshëm. Posaçërisht, larja e qilimave (tepihave) nuk është e lejueshme. Për pastrimin e qilimit (tepihit), shërbimi i shtëpisë së institucioneve të strehimit të përkohshëm ju jep në huazim aparate përkatëse me thithje të lagështisë.

(6) Posedimi ose mbajtja e armëve të çdo lloji ose municioni i tyre është i ndaluar në institucionet e strehimit të përkohshëm. Gjithashtu e ndalueshme është edhe posedimi ose mbajtja e lodrave, të kopjeve të armëve ose municioneve, të cilat duken aq të ngjajshme me armët dhe municionet reale, sa që ato do të konsideroheshin si të vërteta nga ana e paleve të treta.

§ 8 Pastërtia

(1) Banoret dhe banorët duhet të pastrojnë në mënyrë të duhur mjediset e institucioneve të strehimit të përkohshëm dhe hapësirat e tyre.

(2) Mbeturinat shtëpiake duhet të ndahen dhe të largohen nëpërmjet kontejnerëve të mbeturinave të cilët janë në dispozicion. Para hedhjes së mbeturinave të rrezikshme, duhet të konsultohet shërbimi i shtëpisë.

(3) Mbeturinat e rënda penguese mund të vendosen në skajë të rrugës vetëm në ditët e termineve për largim të mbeturinave të rënda penguese, të ndërmarrjes së mbeturinave të qytetit Münster. Papastërtitë në institucionet e strehimit të përkohshëm ose në zonat përreth duhet të hiqen nga vetë ana e shkaktares ose shkaktarit të ndotjes. Nëse ata nuk e bëjnë një gjë të tillë, atëherë punonjësit e Stadt Münster, respektivisht punonjësit e bartësve jopublik do të marrin një gjë të tillë përsipër duke ja llogaritur shpenzimet e krijuara shkaktares ose shkaktarit të ndotjes.

(4) Mbeturinat shtëpiake dhe ato të kuzhinës, si dhe sende të tjera nuk është e lejueshme të largohen nëpërmjet tualeteve, lavamanëve, dusheve ose vaskave.

(5) Ujërat e ndotura mund të derdhen vetëm në kanalet ekzistuese, por jo në hapësira të jashtme.

§ 9 Automjetet motorike

(1) Automjetet motorike mund të parkohen në sipërfaqet e institucioneve të strehimit të përkohshëm vetëm në vendparkingjet ose hapësirat të caktuara për një qëllim të tillë. Hapësirat e parkimit të cilat janë të caktuara për punonjësit, mund të përdoren vetëm nga ana e punonjësve të Stadt Münster ose nga bartësit jopublik.

(2) Vetëm automjetet e regjistruara për qarkullim në trafik rrugor mund të parkohen në sipërfaqet e duhura të institucioneve të strehimit të përkohshëm.

(3) Automjetet e parkuara në mënyrë të paligjshme, do të largohen nga parkingu duke ja llogaritur shpenzimet pronarit të automjetit.

(4) Në sipërfaqet e institucioneve të strehimit të përkohshëm nuk është e lejueshme të behet ndërrimi i vajit dhe riparimi i automjeteve, si dhe larja e automjeteve personale.

§ 10 Largimi

(1) Nëse banoret dhe banorët dëshirojnë të largohen nga njëri prej institucioneve të strehimit të përkohshëm, ata duhet të informojnë menjëherë Stadt Münster, respektivisht shërbimin e shtëpisë - përpara se të largohen - me gojë ose me shkrim.

Çelësat e huazuara dhe sendet tjera duhet të kthehen prapë, përpara zhvendosjes se tyre nga aty.

(2) Nëse një strehim në mënyrë të paautorizuar nuk është i banuar për më shumë se një muaj, Stadt Münster gëzon të drejtën të boshatisë atë. Kostot e ruajtjes së orendive të akomodimit dhe sendeve personale, sikurse edhe kostot e çelësave zëvendësues, duhet të barten nga vetë banoret dhe banorët e mëparshëm,

(3) Stadt Münster kërkon me shkrim që brenda një periudhe të caktuar kohe të të mirren sendet e ruajtura. Nëse kjo nuk ndodh, qyteti i Münster-it ka të drejtën të ankandojë gjërat. Nëse vendbanimi i banoreve dhe banorëve të mëparshëm nuk mund të hulumtohet, qyteti i Münster-it ka të drejtë që tre muaj pas boshtisjes së banesës të ankandojë objektet e magazinuara në ruajtje. Sendet të cilat në mënyrë të dukshme janë të papërdorshme ose të pavlefshme mund të shkatërrohen menjëherë.

Münster, me daten 12.03.2018

nënshkroi,

Markus Lewe
Oberbürgermeister (Kryetari i komunës)